



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.52/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi - kryesues, Hajriz Hoti, dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 23.09.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, ZL.Anr.52/2025 datë 21.09.2025.

II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 2.500,00 Euro (dy mijë e pesëqind Euro).

III. Detyrohet Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Komuna Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës, i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) - z.Përparim Rama, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largoj nga rrjeti social facebook postimin me titull "*Ekskluzive! Sonte në orën 20:00 në T7*" të datës 19.09.2025.

A r s y e t i m

Me datë 21.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Komuna Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë 19 shtator 2025, kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryetar të Komunës së Prishtinës, z. Përparim Rama, ka publikuar në profilin e tij zyrtar në Facebook një video, e cila shërben si paralajmërim për një emision të tij në televizionin T7. Në këtë

video, ai shfaqet duke qëndruar në zyrën e tij si kryetar i komunës së Prishtinës, duke shpërndarë mesazhe dhe informacione lidhur me programin dhe angazhimet e tij për fushatën. Video është incizuar brenda zyrës së kryetarit të komunës, një ambient institucional, i cili në këtë rast përdoret për qëllime fushatash politike, duke shfrytëzuar hapësirën publike për promovimin e kandidaturës së tij. Tutje ka shtuar, Z. Rama duke qenë kryetar i Komunës së Prishtinës, me këtë veprim ai ka shkelur nenin 36, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Bazuar në këto kërkojmë që PZAP të nxjerrë vendim me të cilën do të aprovoj si të bazuar ankesën e PDK-së dhe subjektit politik LDK, t'i shqiptoj dënim me gjobë.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur video në CD dhe linku: https://www.facebook.com/eerparimrama2021/videos/777866425167585/?vh_mibextid=wwXI&rdid=BObxlmnK2cwTxw36#.

PZAP me datë 22.09.2025 i ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë, subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), mirëpo e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë brenda afatit kohor të paraparë në kërkesë, përkatësisht datë 23.09.2025 ora 09:00.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga provat materiale e bashkangjitur ankesës, të Subjektit Politik PDK-së, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për Komunën e Prishtinës, z. Përparim Rama, ka publikuar në profilin e tij zyrtar në Facebook një video, e cila shërben si paralajmërim për një emision të tij në televizionin T7, përmes të cilës është shfaqur duke qëndruar në zyrën e tij si kryetari i komunës së Prishtinës, duke shfrytëzuar hapësirën publike për promovimin e kandidaturës së tij. Bazuar në këtë i njëjti ka shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që është shfrytëzuar institucioni publik, këtë rast Komuna nga zyrtari publik për qëllime elektorale, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *“personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”*.

Sipas vlerësimit të panelit konstatohet se kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama ka shfrytëzuar hapësirat e brendshme të komunës së Prishtinës gjatë fushatës zgjedhore me qëllim të përfitimit të votave. Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimet e kandidatit për kryetar të Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama, bien ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullës zgjedhore nr.07/2024.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim : natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes. Kjo konsiston në atë se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë edhe praktikën e PZAP-it, për rastet të ngjashme, të vendosura në PZAP.

Paneli vlerëson se në rastin konkret kandidati Përparim Rama, përkatësisht subjekti politik LDK, urdhërohet që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largoj postimin me titull “Ekskluzive! Sonte në orën 20:00 në T7” të datës 19.09.2025, ndërsa dështimi për t’iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.52/2025 më datën 23.09.2025

**Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.